

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[12.02.2021]

Për: Bashkimin e Shoqerive “Kastrati Group” sh.a dhe “Kastrati” sh.p.k,

1. Shoqeria "**Kastrati**" **sh.p.k**, rregjistruar si person juridik ne QKB me seli ne Lagjia Nr 14 prane Gjykates se Apelit Shkozet Durres me NIPT J61813529P.
2. Shoqeria "**Kastrati Group**" **sh.a**, rregjistruar si person juridik ne QKB me seli ne Lagjia Nr 14 Ura e Dajlanit Km 1 i Autostrades Durres – Tirane me NIPT K21711502V.

Procedura e prokurimit: “E Hapur -mallra” me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës: REF-82467-12-17-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje karburant Diesel D1 dhe Benzine per vitin 2021”, me fondin total 184,500,000 (Njeqind e tetedhete e kater milion peseqind mije) Leke pa TVSH 12 (dymbedhete) muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Publikime të mëparshme: *Nuk ka*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 122 datë 21 Dhjetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët/ marzhi më i ulët i fitimit

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedure me marzhin e fitimit përkatës të ofruara:

1. Bashkimi i Shoqerive “Kastrati Group” sh.a me nr. NIPT K21711502V dhe “Kastrati” sh.p.k me nr. NIPT J61813529P me marzh fitim 18.2 % per diezel dhe 18.2 % per benzine.
2. Operatori Ekonomik: “A & T” sh.a me nr. NIPT L32320008H me marzh fitim 10.22 % per diezel dhe 10.22 % per benzine.
3. Operatori Ekonomik: “KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k i cili nuk ka paraqitur oferte dhe asnje dokument tjetër te kerkuar ne DT.

* * *

Jane skualifikuar Operatoret ekonomike si meposhte:

1. Operatorin Ekonomik KEVIN KONSTRUKSION shpk pasi:

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike sipas shtojces 2 dhe asnje dokumet tjetër ne lidhje me kete procedure.

2. Operatorin Ekonomik A & T sh.a pasi:

Autriteti Kontraktor ka kerkuar ne DT shtojca për t'u plotësuar nga operatori ekonomik te cilat janë pjesë përbërëse e DT. Operatori Ekonomik A & T sh.a nuk ploteson shtojcat si meposhte:

Shtojcen 2/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur

Shtojcen 6: Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik

Shtojcen 7: Deklarata për konfliktin e interesit

Shtojcen 8: Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme

Shtojcen 8/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave Ligjore në marëdhëniet e punës

Ne dokumentat standarte te tenderit, pika 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.2 AK ka kerkuar qe:

Operatori ekonomik ofertues te paraqese listen e stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice, sipas adresave te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku ne Tirane te jene minimalisht 3(tre) stacione shitje me pakice pasi ka shtrirje teritoriale te madhe dhe perqendrim te shume Institucioneve, kjo vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronesie ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e QKB, etj). Keto stacione te jene te pajisura me Autorizim/Licence leshuar nga pushteti vendore, leje mjedisore te tipit C, vertetim teknik leshuar nga organet e miratuara te vleresimit te Konformitetit (OMVK), Certificate e mbrojtjes nga Zjarri leshuar nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi per distributoret e shitjes me pakice.

Per sa mesiper, OE A & T sh.a, nuk ploteson piken 2.3.2 te DST.

Ne dokumentat standarte te tenderit, pika 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.4 AK ka kerkuar qe:

Operatori ekonomik ofertues te paraqese Vërtetim Teknik te leshuar nga organet e miratuara te vleresimit te Konformitetit (OMVK), Leje Mjedisore te tipit B, te leshuar nga QKL, Certificate e mbrojtjes nga zjarri leshuar nga M.Z.SH, dhe Police Sigurimi leshuar nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per depozitat e tregtimit me shumice qe verteton kapacitetet depozitues mbi 10 000 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, per te garantuar vazhdimesi ne furnizim, sipas kerkesave te autoritetit kontraktor.

Operatori Ekonomik A & T sh.a, nuk ploteson kete pike pasi kapaciteti depozitues eshte 5 000 m³ dhe jo mbi 10 000 m³ si dhe kerkohet nga AK.

Ne dokumentat standarte te tenderit, pika 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.5 AK ka kerkuar qe:

Operatori ekonomik ofertues te paraqese Flete analiza të lëshuar nga ISHTI te cilat duhet të jenë lëshuar brenda 30 diteve nga data e hapjes së ofertave.

Operatori Ekonomik A & T sh.a, nuk ploteson kete pike pasi nuk paraqet flete analizat te leshuara nga ISHTI si dhe kerkohet nga AK.

Ne dokumentat standarte te tenderit, pika 2.3 kapaciteti teknik, pika 2.3.6 AK ka kerkuar qe:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin e panderprere në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha qytetet ku ndodhen autoritet kontraktor, dhe konkretisht - Tiranë, Durrës, Kavajë, Shijak, Krujë, Lushnje, Berat, Kucove, Skrapar, Fier, Vlore, Patos, Ballsh, Gjirokaster, Sarandë, Tepelene, Permet, Korce, Pogradec, Bilisht, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Gramsh, Librazhd, Shkoder, Koplík , Lezhe, Puke, Burrel, Kurbin, Bulqize, Rubik, Diber, Mirdite, Kukes, Tropoj dhe Has.-, me karte elektronike të personalizuar me targon e cdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona në formë biletash, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- OE duhet të paraqesë hartën e vendndodhjeve të distributoreve të tij, (Pikat e karburanteve ku mund të kryhet furnizimi me karta elektronike ose tollona) në pronesi apo me qera APO NE MARREVESHJE ME TE TRETË. Pikat të jenë të shoqeruara me informacionin për pergjegjesin e pikes së karburantit dhe kontaktin.(OE i cili nuk disponon pika karburanti në të gjitha qytetet ku ushtron aktivitet AK, duhet të paraqesë kontrata qiraje apo kontrata bashkëpunimi të lidhura për këtë qëllim me shoqëri të tjera e cila duhet të garantojë përmbushjen të gjitha kriterëve të vendosura në dokumenta tenderi.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin me karburant nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, dhe në tollona në formë biletash sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura në kartën e lektronike të personalizuar me targon e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike dhe tollonat duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme dhe gjatë vitit 2020.
- Operoret ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasise së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasise së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Nderfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.
- Disponimi /Ekzistenca e ndërfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kerkuara mesipër, do të demonstrohen nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktike, në prani anetareve të KVO-se së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

Operatori Ekonomik A & T sh.a, nuk ploteson këte pike pasi nuk paraqet:

- Deklaratën për furnizimin e panderprere të stacioneve të shitjes me pakicë gjatë 24 orëve.
- Hartën e vendndodhjeve të distributoreve të tij ku do të kryhet furnizimi me karta elektronike ose tollona.
- Deklaratën për furnizimin me karta elektronike dhe tollona në formë bilete.
- Deklaratën për furnizimin e plote të sasise së kredituar në kartat elektronike.
- Disponimin e ndërfaqes së menaxhimit të furnizimit me karburant.
- Demonstrimin e ndërfaqes në prani të KVO.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e Operatoreve Ekonomik Kastrati Group sh.a & Kastrati sh.p.k:

1. Shoqeria "**Kastrati**" **sh.p.k**, rregjistruar si person juridik ne QKB me seli ne Lagjia Nr 14 prane Gjykates se Apelit Shkozet Durres me NIPT J61813529P.
2. Shoqeria "**Kastrati Group**" **sh.a**, rregjistruar si person juridik ne QKB me seli ne Lagjia Nr 14 Ura e Dajlanit Km 1 i Autostrades Durres – Tirane me NIPT K21711502V.

se Oferta e paraqitur me marzh fitim 18.2 % per diezel dhe 18.2 % per benzine, piket totale te mara 100 pike, është identifikuar si oferte e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Operatorit të Shpërndarjes se Energjisë Elektrike sh.a, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë, (Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetëse, Njësia e Prokurimit) kopjen e nënshkruar të formularit të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.02.2021

Ankesa: nuk ka